



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

FTESË PËR NEGOCIATË
PËR
AGJENCITË E SPECIALIZUARA PËR TRANSMETIM I FUSHATËS NË RRJETE SOCIALE TË
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE.

Në mbështetje, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, të Këshillit të Ministrave dhe vendimit nr. 725 datë.23.08.2023 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Kukës ne datë 24 Shtator 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të realizojë “Transmetim i fushatës në rrjete sociale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

A- OBJEKTI

“Transmetim i fushatës në rrjete sociale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” për publikim/transmetimin e fushatës “edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese” nëpërmjet mediave sociale dhe platformave online të institucionit të dakortësuar nga publikuesi/transmetuesi dhe reklamuesi vetëm në periudhë zgjedhore

Periudha e realizimit: Realizimimi i shërbimeve do të jetë 10 ditë nga nwnshkrimi i kontratws.

Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën limit 416,666 (katërqind e gjashtëmbëdhjet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë **pa tvsh** ose **500,000 (pesëqind mijë) lekë me tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë

Publikimi i ftesës për negociata: 13 shtator 2023

Afati përfundimtar për paraqitjen e konfirmimeve nga media e shkruar/agjencia e specializuar është më datë 15 shtator 2023 **ora 12:00.**

Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e

subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës **15 shtator 2023, ora 12.00.**

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Transmetim i fushatës në rrjete sociale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", kriteret do të jenë si më poshtë.

B- TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi i këtij shërbimi është: transmetimi/publikimi në rrjetet sociale dhe mediave online në kuadër të fushatës së edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë Kukës.

C- SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:

1. Shërbimin mediatik të mediave sociale të transmetojë/publikojë fushatën e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit
2. Të ritransmetojë të gjitha materialet e fushatës, në rast për arsye të karakterit teknik
3. T'i vërë në dispozicion të shërbimit (Reklamuesit) statistika të publikimit të fushatës për ditët e kërkuar
4. T'i vërë në dispozicion të përfituesit të shërbimit (reklamuesit) në përfundim të shërbimit raporte të publikimit.

Ç- INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Kriteret e pranimit/kualifikimit

1- Kriteret e përgjithshme ligjore:

- A. Ekstrakti i shoqërisë, që është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- B. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv).
- C. Deklaratë që merr përsipër kryeren e shërbimit.

2- Kriteret e përgjithshme profesionale:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të një portofol të punëve të kryera gjatë vitit të fundit të ngjashme më objektin e ftesës për ofertë.
2. Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar në vlerën pa tvsh dhe me tvsh.

D- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomikisht më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme ligjore: 20 pikë**
- **Kriteret e përgjithshme profesionale: 20 pikë**
- **Oferta financiare 60 pikë**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al